



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova

Universiteti i "Ukshin Hoti" Prizren



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS në një të anë,

dhe

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

në anën tjetër,

tutje referuar së bashku si "Palët";

Prishtinë, Janar 2024

Palët kanë arritur pajtim dhe mirëkuptimin për çështjet vijuese, që pasqyrohen në nenet e këtij memorandumi:

Neni 1 Qëllimi

1.1. Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) dhe Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren për fuqizimin e bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit, përmes edukimit dhe arsimimit ligjor si dhe dhënien e ekspertizës profesionale të përbashkët apo edhe aktiviteteve tjera të karakterit arsimor, hulumtues dhe profesional, që reflektojnë fushëveprimin e të dyja institucioneve.

1.2. Qëllimi i këtij memorandumi do të ketë parasysh legjislacionin në fuqi, i cili zbatohet nga palët pjesë e këtij memorandumi.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky memorandum përfshin të drejta dhe obligime reciproke, për palët nënshkruese dhe zbatohet në kuadër të të drejtave dhe obligimeve që marrin palët, duke pasur parasysh qëllimin e tij.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

3.1. Palët pajtohen që të drejtat dhe detyrimet të përcaktohen në përmbajtjen e këtij memorandumi.

3.2. Në rast të dallimeve, palët pajtohen që të zgjidhin dallimet në bazë të mirëkuptimit, përfshirë edhe zgjidhjen që favorizon mundësitë për të dyja palët.

Neni 4 Përgjegjësitë dhe objekti i memorandumit

4.1 Palët pajtohen që të mbështesin njëra tjetrën në mënyrë reciproke, përmes arsimit ligjor, në fushën e sundimit të ligjit, për çështjet si në vijim:

- a) KGJK mbështet Universitetin e Prizrenit për nevojat e Fakultetit Juridik me ekspertizë profesionale nga praktika, në lidhje me programin master të Fakultetit Juridik “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit”;
- b) KGJK, sipas nevojës mundëson pjesëmarrjen e gjyqtarëve, në aktivitetet akademike të programit master të Fakultetit Juridik “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit”;
- c) KGJK ndihmon Universitetin e Prizrenit për nevojat e Fakultetit Juridik dhe studentët e programit master “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit” që të kenë qasje për nevoja studimore në të dhënat e gjeneruara nga burimet elektronike, databazat dhe rastet

praktike të zhvilluara nga Gjykatat të cilat janë në dispozicion për publikun dhe për nevoja hulumtuese;

- d) KGJK mundëson qasjen e personelit akademik të Universitetit të Prizrenit për nevojat e Fakultetit Juridik dhe studentëve të programit master “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit” në vizita të shkurtra studimore në gjykatat e Kosovës, me qëllim të realizimit të programit;
- e) KGJK pajtohet se në rast të nevojës, gjyqtarët të ofrojnë ndihmë profesionale për studentët e programit master “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit”, në rast të vizitave ose pjesëmarrjes të drejtpërdrejtë të gjyqtarëve në aktivitetet e programit, në cilësinë e profesorëve vizitorë;
- f) KGJK pajtohet që t’i mundësojë studentëve të programit master “Qeverisja Demokratike dhe Sundimi i Ligjit”, të Fakultetit Juridik, që të kenë qasje në objektet e gjykatave me qëllim hulumtimi, duke respektuar rregullat etike si dhe t’i ofrojë praktika afatshkurtra me qëllim të zhvillimit profesional;
- g) Universiteti i Prizrenit pajtohet që të mbështesë KGJK, brenda mundësive me ekspertizë profesionale të personelit akademik;
- h) Universitetin e Prizrenit pajtohet që të organizojë sipas nevojës aktivitete profesionale për punëtorët profesional të gjykatave dhe të mbështesë aktivitetet e KGJK-së;
- i) Universitetin e Prizrenit pajtohet që studentët e programit master respektiv dhe studentët e tjerë, sipas nevojës të bëhen pjesë e aktiviteteve zyrtare të KGJK-së dhe të mbështesin ato;
- j) Palët pajtohen që të organizojnë aktivitete të përbashkëta akademike, përfshirë ligjërata si dhe tryeza profesionale, në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

4.2. Të gjitha detyrat e palëve të përcaktuara në këtë nen përmbushen duke pasur parasysh legjisllacionin në fuqi, rregullat e brendshme si dhe rregullat dhe standardet etike.

Neni 5 Mirëbesimi

Palët pajtohen që ky memorandum zbatohet në mirëbesim profesional, duke realizuar obligimet konkrete të këtij memorandumit.

Neni 6 Zbatimi

6.1. Për të gjitha veprimet në përmbushjen e këtij memorandumit, palët nuk kanë obligime financiare ndaj njëra tjetrës.

6.2. Me qëllim të zbatimit të këtij memorandumit palët garantojnë një bashkëpunim dhe komunikim efektiv, përmes nënshkruesve drejtpërdrejtë ose përmes personave përgjegjës që caktohen nga nënshkruesit e këtij memorandumit.

6.3.Palët njoftojnë me shkrim njëra tjetrën për çështjet që janë pjesë e zbatimit të këtij memorandumi, përmes kërkesave ose një plani konkret paraprak të përgaditur.

6.4.Me qëllim të zbatimit të këtij memorandumi palët mbajnë kontakte të rregullta, përmes personave përgjegjës të caktuar paraprakisht dhe të ngarkuar për zbatimin e këtij memorandumi.

Neni 7

Plotësimet dhe ndryshimet në Memorandum

KGJK dhe Universiteti i Prizrenit mund të plotësojnë pjesë të këtij Memorandumi në çdo kohë, nëse për to është dhënë pëlqimi me shkrim i KGJK-së dhe Universitetit të Prizrenit.

Neni 8

Kohëzgjatja e Memorandumit

8.1.Memorandumi ka vlefshmëri të pakufizuar, përpos nëse palët merren vesh ndryshe me shkrim.

8.2.Memorandumi mund të përfundoj me kërkesën me shkrim nga cilado prej palëve nënshkruese, me një paralajmërim prej së paku 30 ditëve.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e një pjese apo në tërësi të këtij memorandumi, ta zgjidhin me mirëkuptim, në frymën e njëjtë me të cilën është nënshkruar ky Memorandum.

Neni 10

Hyrja në fuqi

10.1. Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga palët.

10.2. Memorandumi nënshkruhet në 2 (dy) kopje të njëjta, nga një kopje për secilën palë.

Palët nënshkruese:

Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Për: Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren

Albert Zogaj-Kryesues



Prof.Asoc.Dr.Mentor Alishani-Rektor

